




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial I Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 182/2023  
Datë: 23 shkurt 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 23 shkurt 2023, nxjerr këtë:

**VENDIM**

- I. Miratohet Raporti i Komisionit Mbikëqyrës për zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike për vitin 2022, së bashku me rekomandime.
- II. Obligohen kryeprokurorët e prokurorive të Republikës së Kosovës të zbatojnë rekomandimet e Komisionit si në vijim:
  1. Të kenë bashkëpunim sa më të mirë me prokurorët në trajtimin me prioritet të lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike;
  2. Të ndërmarrin veprime për eliminimin e mospërputhshmërisë së statistikave të raportuara në raport me ato të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim së bashku me Raportin nga pika I e këtij vendimi t'i publikojë në uebportalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku  
  
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Kryeprokurorëve të prokurorive të R. Kosovës;
- Z. Veton Shabani, Kryesues i Komisionit;
- Sekretariatit të KPK-së;